



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

<http://kk.rks-gov.net/istog/>



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja Inauguruese e Legjislacionit të VII^{te} të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: 18.12.2025, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora 11:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|---------------------------------|---------------------------------|
| 1. Naim Behlulaj, LDK; | 15. Ali Nimanaj, PDK; |
| 2. Abedin Kabashi, LDK; | 16. Astrit Hajrizaj, PDK; |
| 3. Agon Dreshaj, LDK; | 17. Kaltrina Arifaj, PDK; |
| 4. Zenel Shatri, LDK; | 18. Arben Kabashi, PDK; |
| 5. Arianit Selmanaj, LDK; | 19. Nexhmedin Balaj, PDK; |
| 6. Kushtrim Buleshaj, LDK; | 20. Lirie Demiraj Sadikaj, PDK; |
| 7. Merita Muzlijaj, LDK; | 21. Astrit Bujupaj, VV; |
| 8. Enver Rugova, LDK; | 22. Niman Beqiraj, VV; |
| 9. Faruk Kabashi, LDK; | 23. Floriana Maxharraj, VV; |
| 10. Ruzhdi Metaj, LDK; | 24. Ukë Blakaj, AAK; |
| 11. Arta Balaj, LDK; | 25. Fjolla Ukaj, AAK; |
| 12. Liridona Lajqi Avdiaj, LDK; | 26. Lulzim Shoshi, L.SH; |
| 13. Ajshe Imeraj, LDK; | 27. Valmir Rama, IRDK; |
| 14. Abetare Sutaj Arifaj, LDK; | |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm: Kryetari i Komunës z. Ilir Ferati, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të shoqërisë civile, mediave, qytetarë, zyrtar administrativ, etj (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje)

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar:

Link:

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, anëtari me i vjetër i kuvendit z. Zenel Shatri.

Anëtari me i vjetër i Kuvendit, Kryesuesi i mbledhjes z. Zenel Shatri – përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje inauguruese, dhe njofton me rendin e ditës për këtë mbledhje.

Procesverbali

Konstaton së të gjithë anëtarët e certifikuar nga KQZ-ja si anëtar të kuvendit Komunal janë prezentë dhe mundë të fillojmë me mbledhjen, vazhdon:

R e n d i t e

Dhënia e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës
Dhënia e betimit të Kryetarit të Komunës
Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Komunës
Mbyllja e mbledhjes

Kryesues i mbledhjes z. Zenel Shatri -- ashtu siç na obligon ligji të dhe aktet nënljore në fuqi, Kuvendi i Komunës në mbledhjen Inauguruese duhet të formoj **Komisionin për Verifikimin e Mandateve**, i përbërë nga tre (3) anëtarë, në këtë përbërje:

1. Agon Dreshaj nga LDK;
2. Arben Kabashi nga PDK dhe
3. Floriana Maxharraj nga VV.

Sekretaria e Kuvendit i ndihmon me material.

Komisioni, pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës të dorëzuar nga sekretaria e Kuvendit ka bërë verifikimin e mandateve të anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Gjatë punës, Komisioni ka shqyrtuar në veçanti:

- Vendimet e organit zgjedhor kompetent për certifikimin e rezultateve zgjedhore;
- Listat përfundimtare të kandidatëve të zgjedhur për anëtarë të Kuvendit Komunal;
- Dokumentacionin tjetër të nevojshëm, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Pas verifikimit të plotë të dokumentacionit dhe konstatimit se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore për ushtrimin e mandatit, Komisioni konstaton se:

Kuorumi për vazhdimin e mbledhjes është (të gjithë anëtarët e zgjedhur janë prezent në mbledhje)

Mandatet e anëtarëve të zgjedhur të Kuvendit Komunal janë të rregullta dhe të vlefshme.

Në bazë të kësaj, Komisioni Konfirmon mandatet e anëtarëve të Kuvendit Komunal, në përputhje me ligjin.

Kryesues i mbledhjes z. Zenel Shatri -- falënderon komisionin.

thërret të gjithë anëtarët e zgjedhur të kuvendit komunal që të ngrihen në këmbë dhe të japin betimin.

Si dhe ta nënshkruajnë deklaratën e dhënies se betimit.

Të gjithë anëtarët e kuvendit dhanë betimin dhe nënshkruan deklaratën,
(deklaratat e nënshkruara me dosjen e anëtarit të kuvendit gjinden në zyrën e kuvendit).

Kryesues i mbledhjes z. Zenel Shatri -- i uron anëtarët e Kuvendit për mandatin e marrë dhe ju uron suksese dhe punë mbarë gjatë këtij mandati katër vjeçar.

Shqyrtimi i pikës dy

Kryesuesi i mbledhjes, z. Zenel Shatri – fjalën ja kalon kryetarit të komunës z. Ilir Ferati, për dhënien e betimit para anëtareve të Kuvendit të Komunës, dhe fjalën përshëndetës.


Kryetari i Komunës z. Ilir Ferati – Jepe betimin dhe nënshkruan deklaratën, (deklarata e nënshkruar gjindtë në dosjen e zyrës së kuvendit komunal)

Përshëndet të gjithë të pranishmit, Anëtarët e Kuvendit të Komunës, të gjithë të pranishmit tjerë që gjendeshin në sallë, falënderon të gjithë qytetaret e komunës së Istogut për besimin e dhen qe të qeverisim bashke edhe për një mandat radhazi, të gjitha premtimet e dhëna do të mundohem qe ti realizojmë se bashku.

Kryesues i mbledhjes, z. Zenel Shatri – uron kryetarin dhe i dëshiron suksese dhe mbarshi në punë,
Faleminderit të gjithëve për pjesëmarrje.
Shpall mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 12:00.

**Procesmbajtëse,
Vjosa Hysenaj**



**Kryesues i mbledhjes,
Zenel Shatri**

